



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:034309

Datë: 31.05.2023

Numri i dokumentit: 04345697

P. nr.101/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË - Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Lavdim Bajraktari me bashkepunëtoren profesionale Flutura Rraqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit E Ç nga S, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.264-12/2021, e datës 23.02.2021, në seancën e shpalljes së aktgjykimit të mbajtur me datë 04.05.2023 në mungesë të të pandehurit, mbojtësit të tij, prokurorit dhe palës së dëmtuar mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 31.05.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari E Q i biri i M dhe nënës Sh e lindur B, i lindur më ---, me numër personal të letërnjoftimit ---, me vendbanim në, Rr.”S” nr.561 S, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me date 29.11.2019 e der më datë 20.08.2020 në S saktësisht në lokalin ‘‘F Th’’ me seli në rrugën ‘‘S’’ nr.561, me anë të lajthimit, largimit apo mënyrave të tjera, me dashje siguron shërbime, për të cilat dihet se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit, duke hapur dhe mbyllur pllombat shtetërore të njësorit nr. me nr. unik të konsumatorit DPZ....., dhe duke eliminuar sistemin e fazës së tretë L3 dhe si pasojë njëhsori elektrik ka regjistruar më pak energjinë elektrike, me ç’rast ndërmarrjes së dëmtuar ‘‘KEDS’’ Distriktit në Prizren i ka shakaktuar dëm material.

-Me këtë ka kryer veprë penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074.

Gjykata Themelore në Prizren dega Suharekë në bazë të neneve 7, 15, 21, 38, 39 par.1 nënpar.1.1, 40 par.1 nënpar. 1.3, 43, 69, 70, 314 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074, neneve 358, 364, 365, 449 par. 2 pika 2.1, 2.6, 2.9, 462 par. 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës 08/L-032 të akuzuarin,

E G J Y K O N

1. Dënim me gjobë në shumën prej 500 € (pesëqind euro), të cilën duhet ta paguaj 15 ditë nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Në rast se nuk paguhet dënimi, dënimi me gjobë do të shndërrohet me dënim me burgim duke llogaritur 20 euro prej dënimit një ditë burgim.

2. Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë euro), në emër të taksës për kompenzim të viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzetë euro), shpenzimet e ekspertit dhe ekspertizen e elektroteknikës në shumën prej 192.96 € (njëqind e nëntëdhjetë e dy euro. nëntëdhjetë e gjashtë euro) të gjitha këto pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar ligjor.

3. E dëmtuara KEDS- Departamenti Ligjor në Prizren lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil

A r s y e t i m

Prokurori i shtetit i Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.264-12/2021, e datës 23.02.2021, e ka akuzuar E C, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 02.05.2023, aktakuzën në këtë seancë e ka përfaqësuar prokurori i shtetit Atnor Skoro dhe gjatë rrjedhës së shqyrtimit, mbrojtësi i të pandehurit Avokat M Q ka kërkuar nga gjykata që të pandehurit ti jepet mundësia nga gjykata edhe në këtë fazë të procedurës penale i akuzuari të shfrytëzoj të drejtën për t'u deklaruar edhe njëherë për aktakuzën që i ngarkohet. Gjykata pas propozimit të mbrojtësit të akuzuarit i ka ofruar mundësinë e deklarimit dhe njëherë në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale derisa edhe eksperti e konstatoj vlerën e dëmit pasi që në këtë qështje vlera ka qenë shume e lartë dhe përkëtë ka qenë kontestuaes pranimi i fajësisë në fazën e mëhershme të procedurës penale, duke thksuar se pranimin e fajësisë e bëjë me vullnet dhe pa presion.

Prokurori i shtetit lidhur me deklarimin e të pandehurit për pranimin e fajësisë nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, meqenëse i njëjti pranim fajësie bëhet në mënyrë vullnetare pas njoftimit nga ana e gjykatës për favorret dhe pasojat e pranimit të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas deklarimit të akuzuarit për akuzën që i ngarkohet, dhe mendimit të prokurorit të shtetit rreth pranimit të fajësisë, ka marrë aktvendim me anë të cilit ka pranuar deklarimin e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për veprën penale që ngarkohet sikurse në aktakuzë, duke vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë sipas nenit 242 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK) 08/L-032, gjyqtari ka vlerësuar se i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari she në prazencën e mbrojtësit të tij, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, dhe se provat në shkresat e lëndës nuk mbështeten në prova të pa pranueshme konform nenit 251 paragraf 3 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPK) 08/L-032.

Pasi që i pandehuri në këtë fazë të procedurës në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë në bazë të nenit 322 para. 4 gjykata vazhdoi me fjalën përfundimtare të palëve.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka theksuar se me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në lidhje me veprën penale objekt i akuzës, në tërësi është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë, i cili pas konsultimit me mbrojtësin e tij në lidhje me veprën penale, natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, e të cialat paraprakisht nga ana e gjykatës të akuzuarit i janë sqaruar rrethana, i cili ka pohuar se në tërësi ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, gjendja faktike është vërtetuar edhe nga administrimi i provave materiale dhe ato personale, si nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe dëgjimi i ekspertit në lidhje me veprën. Këto prova janë në përputhje me njëra- tjetrën gjë që e kanë vërtetuar se

i akuzuari ka kryer veprën penale, i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Në fjalën përfundimtare e dëmtuara ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë fjalës përfundimtare të prokurorit, ndërsa për kërkesën pasuroro- juridike udhëzohemi në kontest civil.

Mbrojtësit të pandehurit avokat M. Q. në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se i akuzuari ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare me qëllim të përmbylljes së kësaj procedure, duke i shprehur keqardhje edhe gjykatës si dhe duke i propozuar që me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ti vlerësoj të gjitha rrethanat lehtësuese që ndikojnë në caktimin e dënimit, duke marr parasysh faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë, i njëjti ka qenë korrekt me organet gjyqësore, është familjar, mbajtës i familjes, i padënuar më parë andaj kërkojmë nga gjykata që ti shqiptohet një dënim i arsyeshëm dhe i butë me veprën penale me çka ngarkohet.

I pandehuri në fjalën e tij përfundimtare ka përkrahur theksimet e mbrojtësit në fjalën përfundimtare, gjithashtu ka kërkuar nga gjykata që të shqiptoj një dënim më të butë, duke i premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëritet kjo veprë penale.

Duke u bazuar në deklarin e të akuzuarit për ta pranuar fajësinë për veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, gjykata nuk administroi me provat në këtë çështje penale juridike, pasi që gjykata ka vërtetuar këtë gjendje të pakontestueshme faktike se i akuzuari;

Me date 29.11.2019 e der më datë 20.08.2020 në Suharekë. Satkësisht në lokalin ‘F Th’ me seli në rrugën ‘S’ nr.561, me anë të lajthimit, largimit apo mënyrave të tjera, me dashje siguron shërbime, për të cilat dihet se mundësohen vetëm me shëmbim të kompensimit, duke hapur dhe mbyllur pllombat shtetërore të njësorit nr. mr nr. unik të konsumatorit: DPZ..... dhe duke eliminuar sistemin e fazës së tretë L3 dhe si pasojë njëhësi elektrik ka regjistruar më pak energjin elektrike, me c’rast ndërmarrjes së dëmtuar ‘KEDS’ Distriktit në Prizren i ka shakaktuar dëm material.

Gjendjen e tillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe nga provat dhe faktet e pa kontestueshme që i përmban aktakuza, siç janë: Procesverbali- raporti mbi ndërrimin e njësorit elektrik nr. e datës 20.08.2020, procesverbali i kontrollit detal të njëhësi me nr. 3473 të datës 04.12.2020, protokollit i shqyrtimit të njëhësi elektrik me nr. 3467 të datës 02.12.2020, Raporti i kalkulimit të shpenimeve të energjisë elektrike nr. të datës 04.12.2020, faturës së rikthimit të humbjeve DPZHP..... të datës 11.12.2020, fotofokumentacionit, deklarata e dëshmitarit G R, A S dhe F M marrë gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ekspertizës së ekspertit të elektros M. Gj. si dhe shkreve të tjera të lëndës.

Gjykata ka vlerësuar dhe konstatuar se nga veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074, i cili duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme dhe me dashje direkte ka siguruar shërbime për të cilat mundësohen vetëm me shëmbim të kompensimit gjegjësisht duke ndërhyrë në njëhësin elektrik ashtu që ka eliminuar sistemin e fazës së tretë L3 dhe si pasojë njëhësi elektrik ka regjistruar më pak energjin elektrike, ku në këtë rast gjykata vlerësoi se janë konsumuar elementet e përgjithshme dhe të veçanta të kësaj veprë penale duke i ka shakaktuar të dëmtuares KEDS – departamenti ligjor në Prizren dëm material, të përcaktuar sikurse në ekspertizën e ekspertit të elektroteknikës.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se e ka pranuar fajësinë në mënyrë të sinqertë pa presion, me vullnet, se ndihet i penduar për veprën penale të cilën e ka kryer dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do t’i përsërisë këtë veprë penale, ndërsa rrethanë rënduese gjykata gjeti se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje duke pas njohuri se ushtron veprimatri ekonomike-afariste.

Për këtë veprë penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet, i akuzuari u gjykua sikurse në dispozitivin e këtij të aktgjykimit, me bindjen se ky dënim është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë që të parandalojë të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)06/L-074.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në nenin 449 parag. 1 dhe 2 nënpar. 2.6 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK) 08/L-032, ashtu që lartësia e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 Euro u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale si dhe gjëndjen financiare të akuzuarit, dhe shumën prej 192.96 €, në emër të shpenzimeve të ekspertit të elektroteknikës, bazuar në nenin 449 parag. 1 dhe 2 nënpar. 2.1, ndërsa shumën prej 20 euro në emër të viktimave të krimit bazuar në nenin 36 parag.3 nënpar. 3.1 të Ligjit mbi Kompenzimin e Viktimave të Krimit nr. 08/L-109.

Vendimin që të dëmtuarës lidhur me kërkesat pasurore juridike për kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale të udhëzojë në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 462 parag. 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK) 08/L-032, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë të kësaj kërkesë.

Nga të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal
P nr. 101/2021 dt. 04.05.2023

G j y q t a r i
Lavdim Bajraktari

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.